



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



European Center for
Not-for-Profit Law



Analizë krahasuese e praktikave ndërkombëtare lidhur me obligimet e raportimit financiar të OShC-ve

Kjo analizë është bërë e mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Qendrë Evropiane për të Drejtën Jofitimprurëse (ECNL) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Analiza është realizuar në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, i cili zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me USAID në Kosovë. ECNL është partnere e KCSF në realizimin e këtij aktiviteti

Hyrje

Obligimet për raportim, përfshirë këtu edhe ato për raportim financiar, paraqesin një pjesë të rëndësishme të punës së organizatave të shoqërisë civile (“OShC”), ndonëse është punë që shpesh konsiderohet jo edhe aq e këndshme për t’u bërë. Raportimi financiar ka rëndësi thelbësore në pasqyrim të transparencës dhe qeverisjes së mirë të OShC-ve dhe mund të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e besimit tek OShC-të dhe në përmirësimin e imazhit të tyre publik. Sistemet e mira të raportimit financiar bazën e kanë tek të drejtat e OShC-ve dhe jo tek ndonjë mekanizëm i kontrollit shtetëror. Këto sisteme përshtaten enkas për sektorin e caktuar dhe bëhen në proporcion me madhësinë dhe llojin e OShC-ve. Me anë të kësaj përmirësohet transparenca e përgjithshme e OShC-ve dhe ato bëhen më të afërta me publikun. Kjo përfundimisht ndikon në rritje të besimit publik në sektorin e caktuar. Kjo analizë është përgatitur nga European Center for Non-Profit Law (ECNL), në bazë të kërkesës nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Analiza synon të theksojë disa praktika krahasimore me qëllim që t’i shërbejë debatit publik rreth nevojës për sistem gjithëpërfshirës të raportimit financiar për OShC-të në Kosovë.

Analiza fillimisht përkufizon standardet ndërkombëtare dhe ato evropiane të raportimit financiar për OShC-të, si dhe instrumentet që janë në mbrojtje të tyre. Në pjesën në vijim, analiza përshkruan konceptin e raportimit financiar dhe përfitimet e mundshme që ai mund të sjellë. Më pas, ofrohet një përmbledhje e gjendjes aktuale të raportimit financiar në Kosovë. Kjo pjesë pasohet nga një krahasim i praktikave të raportimit financiar për OShC-të në Rumani, Itali, Finlandë, Belgjikë dhe Holandë, duke u fokusuar në aspektet në vijim: i) raportimi i cili bazohet në ligjet e kontabilitetit; ii) obligimet e auditimit; iii) raportimi tatimor; iv) raportimet që rrjedhin nga legjislacioni kundër pastrimit të parave; dhe v) kërkesa të tjera lidhur me raportimin. Analiza përfundon me një përmbledhje të mësimëve kryesore dhe rekomandimeve lidhur me politika të aplikueshme në Kosovë.

Ky punim bazohet në hulumtim në internet si dhe në informacion të grumbulluar nga ECNL dhe partnerët e saj, avokatë vendorë, brenda Udhëzuesit Global për Organizatat Jofitimprurëse¹, i cili së shpejti do të publikohet në faqen e internetit të ECNL-së. Paraqitja hartografike e mjedisit legjislativ të raportimit financiar të OShC-ve në Kosovë është bërë me mbështetjen e KCSF-së.

1. Standardet ndërkombëtare dhe evropiane të zbatueshme në raportimin financiar

Është një spektër i gjerë instrumentesh ndërkombëtare dhe evropiane të cilat mbrojnë mjedisin e sigurt dhe të favorshëm për shoqërinë civile, siç janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Sipas saj, çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të drejtën e organizimit. Deklarata ofron garanci për të drejtën e

¹Udhëzuesi Global i Organizatave Jofitimprurëse është një mjet falas për t’u orientuar nëpër ligjet jofitimprurëse në mbarë botën, i cili është zhvilluar bashkërisht nga Qendra Evropiane për Ligjin Jofitimprurës (ECNL), DLA Piper dhe PILnet, me mbështetje bujare nga avokatë pro bono nga e gjithë bota. Udhëzuesi ofron informacion të lehtë për t’u përdorur për regjistrimin, funksionimin dhe mbylljen e OSHC-ve.

privatësisë duke thënë se askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare në privatësi. Deklarata gjithashtu prezanton parimin e mos-diskriminimit sipas të cilit "Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë pa asnjë diskriminim nga ligji..."²Një instrument tjetër ndërkombëtar, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike ("ICCPR"), thotë se "...Të gjithë do të kenë të drejtën e lirisë së organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave për mbrojtje të interesave të tyre." Kufizimet në këtë të drejtë lejohen vetëm në raste të veçanta të cilat përshkruhen më poshtë në seksionin "Liria e asociimit ". Dokumenti siguron gjithashtu garanci për të drejtën e privatësisë dhe thekson zbatimin e parimit të mos-diskriminimit dhe mbrojtjen e barabartë nga ligji.³ Një nga instrumentet më të rëndësishme në nivel evropian që ofron garanci për këto liri është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ngjashëm me instrumentet më sipër, Konventa siguron mbrojtje për lirinë e organizimit dhe tubimit, të drejtën për privatësi dhe trajtim të barabartë.⁴

Kërkesat e raportimit për OShC kanë ndikim në mjedisin në të cilin veprojnë OShC-të dhe për këtë arsye, ato duhet të jenë në përputhje edhe me standardet e përfshira në këto instrumente. Këto standarde zakonisht përfshijnë komponentë të lirisë së organizimit, të drejtës për privatësi dhe parimit të mos-diskriminimit.

Liria e asociimit

Si pjesë e lirisë së asociimit, OShC-të duhet të jenë të lira të veprojnë dhe të kryejnë aktivitetet e tyre. Raportimi financiar **nuk duhet të kufizojë aktivitetet e OShC-ve dhe të krijojë pengesa të ndryshme burokratike**, të cilat çojnë në kufizim të lirisë së asociimit . Kjo është theksuar edhe nga Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut në rezolutën e Këshillit nr 22/6 të datës 21 mars 2013, në të cilën u bëri thirrje shteteve të sigurojnë që kërkesat e raportimit "*nuk pengojnë autonominë funksionale [të shoqatave]*" dhe "*nuk imponojnë kufizime në mënyrë diskriminuese në burimet e mundshme të financimit.*"⁵

Çfarëdo kufizimi ose shtrëngimi i mundshëm i lirisë së asociimit(apo çfarëdo vështirësimi i funksionimit të OShC-ve, duke përfshirë detyrimet e raportimit) duhet të: i) jetë i përshkruar me ligj; ii) jetë në shërbim të një qëllimi legjitim; dhe iii) jetë i nevojshëm dhe proporcional.⁶

- i. *Ligjshmëria.* Për të përmbushur parimin e ligjshmërisë, kërkesat e raportimit duhet të përfshihen në ligj, të jenë të qarta dhe të parashikueshme. Ato duhet të ofrojnë qartësi të mjaftueshme mbi

² Kombet e Bashkuara: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, nenet 7, 12 dhe 20(1). Në dispozicion tek: [NR004388.pdf \(un.org\)](#)

³ Kombet e Bashkuara: Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, nenet 17, 22 dhe 26. Në dispozicion tek: [International Covenant on Civil and Political Rights | OHCHR](#)

⁴ Këshilli i Evropës: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 8, 11 dhe 14. Në dispozicion tek: [European Convention on Human Rights \(coe.int\)](#).

⁵ Këshilli për të Drejtat e Njeriut, RES/22/6 Mbrojtja e Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut, 21 mars 2013. Në dispozicion tek: [RES/22/6 Mbrojtja e mbrojtësve të të drejtave të njeriut / RightDocs - Kujtojnë rezolutat për të drejtat e njeriut \(right-docs.org\)](#)

⁶Këto parime janë të përfshira, për shembull, në Art. 29(2) të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut ose Art. 22(2) të ICCPR-së.

detyrimet, shkeljet e mundshmeve dhe sanksionet si pajsojë e mosrespektimit.

- ii. *Qëllimi legjitim.* Sipas standardeve ndërkombëtare, synimet legjitime përfshijnë “*interesat e sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për parandalimin e çrregullimeve apo krimeve, për mbrojtjen e shëndetit apo moralit apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve*”. Megjithatë, këto prapëseprapë duhet të plotësojnë kërkesat e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë. Raportuesi Special i OKB-së në një nga raportet e tij tematike theksoi se përfshirja e masave të kundër-terrorizmit ose anti-ekstremizmit në emër të sigurisë kombëtare e të sigurisë publike për të ndaluar pikëpamjet ndryshe ose për të shtypur shoqërinë e pavarur civile përbëjnë shkelje të ligjit ndërkombëtar. Shtetet kanë obligim të vërtetojnë ekzistencën e kërcënimit kur përdoren masa kufizuese dhe se masat e marra janë aplikuar për të përballuar atë kërcënim. Për të përmbushur testin e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë, masat kufizuese duhet të jenë masat kufizuese duhet të jenë metoda më pak ndërhyrëse (intruziv) për arritjen e qëllimit të dëshiruar dhe gjithashtu duhet të jenë të kufizuara në fushëveprim.”. Kjo do të thotë se masat e tilla nuk duhet të synojnë shoqërinë civile si tërësi, por të kufizohen tek shoqatat për të cilat vlejnë aspektete identifikuar e që karakterizojnë qartë vetëm terrorizmin. Për më tepër, ligjet e hartuara në terma të përgjithshëm të cilët kufizojnë, apo edhe ndalojnë financimin duke u justifikuar në emër të kundër-terrorizmit, nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e "proporcionalitetit" dhe "domosdoshmërisë".⁷
- iii. *Domosdoshmëria dhe proporcionaliteti.* Duhet të ketë prova të qarta që masat e propozuara (dmth. raportimi) i përgjigjen kërcënimit konkret (p.sh. pastrimit të mundshëm të parasë) dhe dizajnohen për të zgjidhur problemet e identifikuar. Kërkesat e raportimit dhe niveli i përpjekjeve që ato presin duhet të jenë gjithashtu proporcionale me madhësinë e organizatës. Sipas Udhëzimeve të Përbashkëta për Lirinë e Asociimit të Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR, kërkesat për raportim nuk duhet të jenë ngarkesë e panevojshme, por proporcionale me madhësinë e organizatës dhe fushëveprimin e aktiviteteve të saj, duke marrë parasysh vlerën e aseteve dhe të hyrave të saj.⁸

E drejta për privatësi

Kur rregullat e raportimit financiar kërkojnë nga OShC-të të raportojnë informacione personale, për shembull, lidhur me donatorët, kërkesa e tillë duhet të jetë në përputhje me garancitë ndërkombëtare të së drejtës për privatësi. Sipas Rekomandimit të Këshillit të Evropës, i tërë raportimi duhet t'i nënshtrohet detyrimit për të respektuar të drejtën e privatësisë së donatorëve, përfituesve dhe

⁷Raporti i Raportuesit Special për të drejtat e lirisë së tubimit paqësor dhe organizimit, Maina Kiai, A/HRC/23/39, para. 22-26. Në dispozicion tek: [Kombet e Bashkuara](#).

⁸Udhëzimet e Përbashkëta të OSBE/ODIHR-Komisionit të Venecias për Lirinë e Organizimit, para. 104. Në dispozicion tek: [default.aspx \(coe.int\)](#).

stafit, si dhe të drejtën për të mbrojtur konfidencialitetin legjitim të biznesit.⁹ Në raste të jashtëzakonshme, interesi i përgjithshëm mund të arsyetojë qasjen në informacione private ose konfidenciale nga ana e autoriteteve, për shembull për të parandaluar transferet e parave në tregun e zi. Megjithatë, çfarëdo përjashtimi ndaj konfidencialitetit të biznesit apo privatësisë dhe konfidencialitetit të donatorëve, përfituesve dhe stafit duhet të respektojë parimin e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.

Gjithashtu duhet të bëhet dallimi ndërmjet “detyrimeve të raportimit” (raportimi i informacionit tek autoritetet) dhe “detyrimeve për shpalesje publike” (bërja publike e informacionit apo vënia e informacionit në dispozicion për publikun e gjerë). Në raportin e tij, Komisioni i Venecias thekson se ndërkohë që disa detyrime të raportimit do të mund të konsideroheshin si zbatim i qëllimit legjitim për të garantuar sigurinë kombëtare dhe parandalimin e çrregullimeve e të krimit, “detyrimi për të bërë publik informacionin lidhur me burimin e financimit (detyrimi për shpalesje publike) nuk duket se është në gjendje të ndjekë të njëjtin objektiv”.¹⁰

E drejta për barazi dhe mos-diskriminim

Kur bëhet fjalë për kërkesat e raportimit financiar, OShC-të nuk duhet të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se bizneset apo personat e tjerë juridik. Sipas Komisionit të Venecias “Shoqatat nuk duhet të obligohen të paraqesin më shumë raporte e informacione se subjektet tjera juridike, si bizneset, dhe duhet të ushtrohet barazi mes sektorëve të ndryshëm”¹¹. Po ashtu, Raportuesi Special i OKB-së për të drejtat për liri të tubimit paqësor dhe organizimit, në një nga raportet e tij theksoi si praktikë të mirë një sistem auditimi i cili në thelb përcakton kritere të ngjashme për shoqatat dhe bizneset. Madje, ai theksoi se **praktika më e mirë është ofrimi i kërkesave të thjeshtuara të auditimit dhe raportimit për OShC-të: “praktika më e mirë është të institucionalizohen procedura të thjeshtuara të auditimit dhe raportimit...[për OShC]... të cilat mund të mos kenë burimet financiare e njerëzore për të qenë në pajtueshmëri me rregullore më komplekse financiare.”**¹²

2. Raportimi financiar i OShC-ve

Raportimi financiar paraqet detyrim për OShC-në që raportojnë të hyrat dhe shpenzimet dhe t'ia dorëzojë atë institucioneve relevante, kryesisht autoriteteve shtetërore. Shtetet zakonisht vendosin detyrimet e raportimit financiar për OShC-të për qëllime transparence dhe llogaridhënieje. Është me rëndësi të monitorohen të hyrat dhe shpenzimet, të sigurohet pajtueshmëri me rregullore të detyrueshme të kontabilitetit, t'u komunikohen të dhënat thelbësore palëve kryesore dhe

⁹ Këshilli i Evropës: Rekomandimi CM/Rec(2007)14 mbi statusin ligjor të organizatave joqeveritare në Evropë, para. 64. Në dispozicion tek: <https://www.coe.int/en/web/ingo/legal-standards-for-ngos>.

¹⁰ Komisioni i Venecias: Raporti për Financimin e Shoqatave, para. 95. Në dispozicion tek: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)002-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)002-e).

¹¹ Udhëzimet e Përbashkëta të OSBE/ODIHR-Komisionit të Venecias për Lirinë e Organizimit, para. 225.

¹² Raporti i Raportuesit Special të OKB për të drejtat e lirisë së tubimit paqësor dhe organizimit nr A/70/266, para. 57. Në dispozicion tek: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N15/242/64/PDF/N1524264.pdf?OpenElement>

autoriteteve shtetërore, si dhe të kryhen analiza për të mbështetur vendimet e biznesit. Faktorë të ndryshëm mund të luajnë rol në përcaktimin e detyrimeve specifike të raportimit financiar dhe fushëveprimin të raportimit, duke përfshirë kontekstin politik, kulturor dhe ekonomik të vendit. Shtetet me traditë relativisht të re demokratike dhe përvojë të shkurtër bashkëpunimi me shoqërinë civile mund të paraqesin kërkesa më të rënda raportimi dhe t'i bëjnë OShC-të subjekt mbikëqyrjeje më intensive.

Si praktikë më e mirë, gjatë përcaktimit të llojit dhe masës së detyrimit të raportimit financiar duhet të merret parasysh madhësia e OShC-së dhe vëllimi i të hyrave të saj. Shumica e vendeve që merr në shqyrtim ky dokument kanë paraqitur kërkesa më pak të rrepta raportimi për OShC-të e vogla në krahasim me ato më të mëdha. Në kapitullin 5 më poshtë jepet më shumë informacion krahasues mbi detyrimet e raportimit financiar që aplikohet në vende të ndryshme.

Kur hartohen kërkesat e raportimit financiar është me rëndësi të merret parasysh konteksti ekonomik dhe kulturor i vendit, traditat rregullative dhe korniza ligjore ekzistuese aktuale. Po ashtu, gjatë zhvillimit të rregullave të raportimit, duhet të merren parasysh specifikat e funksionimit të OShC-së, duke përfshirë natyrën e saj jofitimprurëse. Detyrimet e raportimit financiar që hartohen në mënyrë efektive dhe të cilat marrin parasysh natyrën specifike të OShC-ve mund tu sjellin disa përfitime të ndryshme organizatave. Transparenca në llogaritë dhe operacionet e OShC-ve u mundëson atyre të vendosin themelet e besueshmërisë së tyre dhe të fitojnë besimin dhe mbështetjen e publikut. Ato informojnë palët e interesuara lidhur me misionin institucional dhe mjetet me anë të të cilave OShC-ja e caktuar ka përdorur burimet financiare në kryerjen e aktiviteteve të saj jofitimprurëse.

Detyrimet e raportimit financiar mund të burojnë edhe nga pranimi i mbështetjes shtetërore (qoftë nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë apo përfitimeve tatimore indirekte) ose financimit nga burime të tjera. OShC-të zakonisht janë subjekt i raportimit shtesë/të veçantë kur pranojnë fonde shtetërore në formë të granteve apo subvencioneve ose kur mbledhin fonde nga donatorë individualë dhe korporatave. Zakonisht, kërkesat e raportimit në raste të tilla bazohen në kontratën e financimit dhe/ose kërkesat e donatorëve përkatës.¹³

3. Raportimi financiar i OShC-ve në Kosovë

Në Kosovë ekziston një sistem kompleks i raportimit financiar për OShC-të. faza. Ai përfshin raportimin për subjektet e mëposhtme:

1. Administrata Tatimore: OShC-të obligohen të raportojnë transaksionet financiare dhe pasqyrat financiare vjetore tek Administrata Tatimore, si dhe tatimin mbi pagat, tatimin e korporatave, tatimin në pronë/qira dhe tatimin

¹³ ECNL: Kërkesat e raportimit për OShC-të: Pasqyrë e rregullores së vendit. Në dispozicion tek: [ECNL-Përmbledhje-OSHC-Raportimi.pdf](#).

mbi kontributet pensionale, sipas rastit. Kjo bazohet në Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

2. Departamenti për OJQ: OShC-të me status të përfitimit publik duhet të dorëzojnë edhe një raport vjetor për veprimet dhe aktivitetet e tyre tek Departamenti për Organizata Joqeveritare jo më vonë se 31 mars i vitit vijues pas vitit kalendarik. Seksioni i pasqyrave financiare duhet të përmbajë bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve.¹⁴ Pasqyrat financiare duhet të auditohen nga një auditor i pavarur ligjor për OShC-të lokale me status të përfitimit publik, që kanë të hyra ose shpenzime vjetore mbi 100,000 Euro.¹⁵
3. Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës (NjIF-K): Ligji Nr. 05/L-096, Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (Ligji PPP/LFT)¹⁶ i konsideron të gjitha OJQ-të si subjekte raportuese. Ky ligj kërkon që ato të raportojnë të gjitha veprimet ose transaksionet e dyshimta tek NjIF-K brenda 24 orëve nga koha kur akti ose transaksioni identifikohet si i dyshimtë. Subjektet raportuese gjithashtu duhet të caktojnë një zyrtar të pajtueshmërisë. Përfaqësuesi i autorizuar, në parim duhet të jetë zyrtari i pajtueshmërisë dhe personi kontaktues me NjIF-K, përveç nëse OJQ-ja e specifikon ndryshe me anë të një vendimi me shkrim dhe e njofton në mënyrë të rregullt NjIF-K-në. OJQ-të duhet të mbajnë libër/të dhëna financiare që dokumentojnë të gjitha të hyrat dhe shpenzimet. Këto të dhëna duhet të identifikojnë të hyrat sipas burimit, shumës dhe mënyrës së pagesës, dhe do të identifikojnë shumën e paguar nga pranuesi, përdorimin e synuar të fondeve dhe mënyrën e pagesës. Dokumentet lidhur me të dhënat financiare do të mbahen për pesë (5) vjet dhe do të jenë në dispozicion me kërkesë të NjIF-K-së dhe organit kompetent sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare (“Ligji për OJQ-të”). OShC-të gjithashtu kanë kufizime sa i përket shumave që mund të pranojnë si kontribute në para të gatshme. OJQ-të duhet t'i shpalosin detajet dhe informacionin lidhur me këtë në raportin vjetor të dorëzuar në pajtim me Ligjin për OJQ-të.¹⁷

Sipas raportit nga shteti i Kosovës, i përgatitur në kuadër të kornizës monitoruese të Matricës së Monitorimit për Ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile, “*Legjislacioni i Kosovës sa i përket raportimit financiar dhe rregullave të kontabilitetit nuk merr parasysh natyrën specifike të OShC-ve*”¹⁸. Sipas Raportit, “*...kërkesat e raportimit tek Administrata Tatimore, si dhe sanksionet për mosplotësimin e këtyre kërkesave raportuese nuk marrin parasysh veçoritë e OShC-ve, por janë*

¹⁴ Ligji nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, neni 38

¹⁵ Po aty

¹⁶ Ligji nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, në dispozicion tek: [LIGJI NR.05/L-096 PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTIMIT TË FINANCIMIT TË TERRORIZMIT \(rks-gov.net\)](https://www.rks-gov.net/legjislacioni/ligji-05-l-096-për-parandalimin-e-pastrimit-të-parave-dhe-luftimit-të-financimit-të-terrorizmit)

¹⁷ Po aty Neni 16, 29

¹⁸ KCSF: Matrica e Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, raporti i shtetit të Kosovës, 2019. Në dispozicion tek: https://www.balkancsd.net/novo/wp-content/uploads/2021/01/MM-2020_Kosova-country-report_final.pdf.

identike/proporcionale me bizneset.”¹⁹ Në anën tjetër, Ligji ëëNr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (Ligji për Kontabilitetë)²⁰, që përcakton kërkesat e përgjithshme për raportim financiar për të gjitha bizneset dhe kompanitë publike nuk i përfshin fare OShC-të. Përveç llogaritjes së detyrimeve tatimore që vlen për pak OShC që kualifikohen për pagesë tatimi mbi korporatat, institucionet publike nuk kanë një mënyrë sistematike për të mbledhur informacion të saktë lidhur me aspektet financiare të sektorit të OShC-ve. Vetëm një pjesë e OShC-ve përmbushin kërkesat e raportimit dhe madje edhe ato që e bëjnë këtë, kanë vështirësi që bilancet e tyre t’i paraqesin sipas formateve të raportimit që janë të dizajnuara për kompanitë private.

Sipas Raportit, ligji PPP/LFT nuk është në përputhje me Rekomandimet e Task Forcës për Veprim Financiar (FATF) dhe Direktivën e BE-së 2015/849. Direktiva e BE-së nuk përfshin organizatat jofitimprurëse ("OJF") si subjekte të detyruara. Neni 4 i Direktivës i lejon shtetet që "në përputhje me qasjen e cila bazohet në risk/rrezikshmëri" të zgjerojnë listën e subjekteve të detyruara dhe të përfshijnë kategoritë e ndërmarrjeve "të cilat angazhohen në aktivitete të caktuara të cilat kanë gjasa të përdoren për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit". Siç mund të shihet nga tekstet e cituara, shtimi i kategorive të personave dhe aktiviteteve ndryshe nga ato të listuara në Direktivë duhet të bazohet në gjasa (probabilitet) të dëshmuara të riskut (rrezikshmërisë) se ato do të përdoren për pastrim parash apo financim terrorizmi. Prandaj, përfshirja e OJF-ve mund të bazohet vetëm në qasjen e cila bazohet në risk (rrezikshmëri), pasi të jetë kryer një vlerësim specifik i riskut për të identifikuar ato që janë me rrezik të lartë abuzimi me pastrimin e parave - e jo të gjitha OJF-të.

4. Shembuj krahasues të modeleve të raportimit financiar

Në këtë pjesë paraqiten shembuj krahasues të kërkesave të raportimit financiar për organizatat e shoqërisë civile në Evropë, të cilat rrjedhin nga legjislacioni mbi OShC-të, legjislacioni tatimor, legjislacioni mbi kontabilitetin dhe legjislacioni kundër pastrimit të parave (PPP). Analiza fokusohet në kërkesat e zbatueshme për OShC-të në Rumani, Itali, Finlandë, Belgjikë, Kroaci dhe Holandë.²¹ Përzgjedhja është bërë për të shfaqur disa modele raportimi financiar që ekzistojnë në Evropë. Gjithashtu, përzgjedhja është bërë për edhe për shkak të diversitetit të tyre gjeografik duke përfshirë kështu legjislacionin e raportimit financiar nga rajonet e Evropës jugore, veriore, perëndimore dhe lindore.

Në secilin seksion të mëposhtëm, janë përshkruar kërkesat bazike të raportimit financiar, janë analizuar modelet e ndryshme të raportimit financiar në shtetet e

¹⁹ Po aty

²⁰Ligji 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, në dispozicion tek: [LIGJI NR. 04/L-014 PËR KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM \(rks-gov.net\)](https://www.rks.gov.net/LIGJI-NR-04/L-014-PËR-KONTABILITET-RAPORTIM-FINANCIAR-DHE-AUDITIM)

²¹Për qëllimet e këtij punimi, janë shqyrtuar llojet e organizative në vijim: Rumania: shoqata dhe fondacione, Itali: organizata vullnetare të inkuorporuara si shoqata dhe fondacione, Finlanda: shoqata dhe fondacione, Belgjikë: shoqata jofitimprurëse, fondacione private, fondacione me interes publik, Holandë: organizata që përfaqësojnë interesa shoqërore (OPISH), organizata me përfitim publik (ANBI), fondacione që mbështesin një OPISH

përzgjedhura dhe janë ofruar shembuj me detaje të mëtejshme të cilat janë paraqitur në kutitë me tekst.

4.1 Rregullat e kontabilitetit

Në të gjitha shtetet e përfshira në këtë dokument, OShC-të obligohen të mbajnë libra të të hyrave dhe shpenzimeve të tyre. Në **Belgjikë, Finlandë, Kroaci dhe Itali**, përmasat e kësaj **kërkese përcaktohen në bazë të madhësisë së OShC-së dhe/ose të hyrave të saj**. Ligjet në **Belgjikë** njohin llojet e mëposhtme të OShC-ve: a) OShC të vogla, duke përfshirë ato mikro; dhe b) OShC të mëdha dhe shumë të mëdha. OShC-

OShC-ja i përket **kategorisë së OShC-ve të vogla dhe mikro** nëse ajo nuk tejkalon më shumë se një nga pragjet e mëposhtme (varësisht prej përshtatjes së indeksit të çmimeve të konsumit (CPI):

- Numri mesatar i punonjësve gjatë vitit është pesë apo më pak;
- Të ardhurat vjetore janë 334,500 euro pa TVSH ose më pak;
- Bilanci i gjendjes arrin në maksimumi 1,337,000 euro pa TVSH.

Nëse të paktën dy pragje tejkalohen brenda një viti, OShC-ja i përket **kategorisë së OShC-ve të mëdha dhe shumë të mëdha**.

të e vogla dhe ato mikro mund të mbajnë llogari të thjeshtuara dhe duhet t'i paraqesin llogaritë e tyre vjetore tek nëpunësi i gjykatës kompetente për Ndërmarrje. OShC-të e mëdha dhe ato shumë të mëdha duhet të paraqesin llogaritë e tyre vjetore tek Banka Kombëtare e Belgjikës. Llogaritë e thjeshtuara përbëhen nga informacioni i mëposhtëm: i) llojet e të hyrave dhe shpenzimeve dhe shumat e tyre; ii) diagrami i vlerësimit duke përfshirë totalin e aseteve dhe borxheve të OShC-së, të drejtat financiare si dhe angazhimet dhe të drejta e angazhime të tjera të rëndësishme që nuk mund të përcaktohen në sasi. Nga ana tjetër, OShC-të e mëdha i nënshtrohen detyrimeve të regjistrimit të dyfishtë, të cilat përfshijnë bilanc të gjendjes dhe pasqyrë të të hyrave. Bilanci i gjendjes obligon ofrimin e informacionit të detajuar mbi asetet (pasuritë) aktive, duke përfshirë asetet fikse dhe stoqet, si dhe asetet pasive, duke përfshirë fondin social, provizionet dhe tatimet e shtyra, informacion të detajuar mbi borxhet etj. Pasqyra e të hyrave shqyrton shitjet dhe shërbimet, koston e shitjeve dhe shërbimeve, fitimin ose humbjen operative, produktet financiare etj. Kur krahasohen dy formatet e raportimit, niveli i detajeve të kërkuara nga OShC-të e mëdha është shumë më i lartë se nga OShC-të e vogla dhe ato mikro.²²

Në **Kroaci**, OShC-të duhet në përgjithësi të kryejnë kontabilitet të dyfishtë, përveç nëse plotësojnë kërkesat e mëposhtme: i) vlera e aseteve të organizatës jofitimprurëse në fund të tre viteve të fundit është më pak se 230,000.00 HRK (rreth

²² Dekreti Mbretëror i 29 Prillit 2019 për zbatimin e Kodit të Kompanive dhe Shoqatave, Aneksi 6, 7 dhe 8. Në dispozicion tek: [Dekreti Mbretëror i 29 Prillit 2019 për zbatimin e Kodit të Kompanive dhe Shoqatave | CNC CBN \(cnc-cbn.be\)](#)

30,600 euro); dhe ii) të hyrat vjetore të organizatës jofitimprurëse në tre vitet e fundit janë më pak se 230,000.00 HRK në vit. Në rast të tillë, një përfaqësues i OShC-së mund të vendosë të mbajë kontabilitet të thjeshtë para afatit të dorëzimit për vitin fiskal paraprak. Vendimi i tillë është i vlefshëm për periudhën kur OShC-ja përmbush kërkesat e mësipërme apo deri kur të jetë revokuar. Sidoqoftë, duhet të theksohet se OShC-ja është e detyruar të kryejë kontabilitet të dyfishtë për tre vitet e para pas themelimit të saj. OShC-të me raportim të thjeshtuar duhet të mbajnë: i) librin e arkës; ii) librin e faturave dhe shpenzimeve; iii) librin e llogarisë hyrëse; iv) librin e kontabilitetit të daljes; dhe v) listën e aseteve fikse jofinanciare. Në krahasim, OSHC-të që detyrohen të bëjnë kontabilitet të dyfishtë duhet të përgatisin plan financiar dhe të mbajnë ditar, libër kryesor, regjistra ndihmës dhe libra ndihmës. Librat ndihmës përfshijnë: i) librin e aseteve fiksejofinanciare; ii) librin e aseteve jofinanciare afatshkurtra; iii) librin e aseteve dhe detyrimeve financiare; iv) librin (ditarin) e arkës së parave; v) regjistrat e urdhrave të udhëtimit dhe përdorimit të automjeteve zyrtare. Edhe numri i dokumenteve dhe fushëveprimi i informacionit të kërkuar është më i gjerë për OShC-të e mëdha.²³ Përveç kësaj, OShC-të në Kroaci obligohen të hartojnë pasqyrat financiare të cilat duhet të dorëzohen çdo vit tek Ministria e Financave. OShC-të e vogla obligohen vetëm të paraqesin deklaratë për të hyrat dhe shpenzimet. Organizatat e mbetura duhet të dorëzojnë deklaratë mbi situatën dhe strukturën, si dhe ndryshimet në vlerën dhe vëllimin e aseteve, detyrimeve, burimeve vetanake, të hyrave dhe shpenzimeve.²⁴

Në **Itali**, OShC-të me të hyra vjetore që nuk i tejkalojnë 220,000 euro duhet të hartojnë vetëm pasqyrat vjetore të rrjedhës financiare. OShC-të me të hyra në vlerë 220,000 euro apo më shumë duhet të hartojnë pasqyra financiare të cilat përbëhen nga bilanci i gjendjes, deklaratë e menaxhimit e cila tregon të hyrat dhe shpenzimet e organizatës, si dhe një deklaratë misioni e cila ilustron zërat e bilancit të gjendjes, performancën ekonomike dhe menaxhuese të organizatës dhe mënyrën se si organizata ndjekë qëllimet e saj statutore. Për këtë qëllim, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale ka hartuar formularë të dedikuar posaçërisht për OShC-të të cilat nuk kanë angazhim primar në aktivitetet ekonomike.²⁵ OShC-të që kryejnë kryesisht aktivitete ekonomike, si ndërmarrjet sociale, zbatojnë të njëjtat kërkesa dhe përgadisnin formularë të njëjtë sikurse personat juridikë tregtarë.²⁶

Në **Rumani** dhe **Holandë**, fushëveprimi i kërkesave të kontabilitetit dhe detyrimet e raportimit varen nga fakti nëse organizata angazhohet në aktivitete ekonomike. Në **Rumani**, OShC-të që nuk kryejnë aktivitete ekonomike hartojnë vetëm një pasqyrë financiare të thjeshtuar, e cila përbëhet nga një bilanc i përmbledhur i gjendjes dhe një llogari e shkurtuar e fitimit ose humbjes për vitin e caktuar financiar. Në **Holandë**, OShC-ve që nuk angazhohen në aktivitete ekonomike nuk u kërkohet të

²³Ligji për Veprimtarinë Financiare dhe Kontabilitetin e Organizatave Jofitimprurëse nr. OG 121/14, Neni 9, 13-16. Në dispozicion tek: [Ligji për Veprimtarinë Financiare dhe Kontabilitetin e Organizatave Jofitimprurëse - Zakon.hr](#)

²⁴Po aty Neni , 29

²⁵Dekreti i Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale, datë 5 mars 2020: <https://www.gazzettaufficiale.it/eli/id/2020/04/18/20A02158/sg>

²⁶Cantiere Terzio Settore: Si funksionon standardi i ri i kontabilitetit për sektorin e tretë, 2 mars 2022. Në dispozicion tek: [Si funksionon standardi i ri i kontabilitetit për sektorin e tretë - Cantiere Terzo Settore](#)

paraqesin asnjë raport financiar. Megjithatë, ato duhet të mbajnë libra me: a) shumat që janë paguar nga organizata, nga çdo drejtor, për të rimbursuar shpenzimet dhe tarifat e pjesëmarrjes; b) shpenzimet e bëra nga organizata; c) të hyrat dhe asetet e organizatës.²⁷

4.2 Kërkesat e auditimit

Në të gjitha shtetet e përfshira në këtë analizë, ka disa kërkesa për auditimin e raporteve financiare. Megjithatë, kjo kërkesë zbatohet për OShC-të vetëm nën kushte të caktuara, zakonisht kur arrihet një prag financiar ose kur numri i punonjësve/anëtarëve tejkalon një numër të caktuar. Këto pragje janë më të larta në të gjitha shtetet **për të shmangur imponimin e kërkesave të rënduara të raportimit për OShC-të e vogla** me qarkullim të ulët dhe/ose me shumë pak apo pa asnjë punonjës.

Në **Finlandë** obligimi vlen për shoqata të cilat plotësojnë më shumë se një nga kushtet e mëposhtme për vitin e fundit financiar apo parafundit financiar: a) totali i bilancit të gjendjes tejkalon 100,000 euro; b) shitjet neto apo të hyrat e krahasueshme tejkalojnë 200,000 euro; ose c) numri mesatar i punonjësve tejkalon 3. Të gjitha fondacionet janë subjekt i auditimit.

Në **Itali**, obligimi vlen nëse, për dy vite financiare të njëpasnjëshme janë tejkaluar dy nga pragjet e mëposhtme: a) vlera totale e asetëve: 1,100,000 euro; b) të hyrat, të ardhurat, faturat me çfarëdo emërtimi: 2,200,000 euro; c) numri mesatar i punonjësve gjatë vitit është 12 ose më shumë.

Në **Belgjikë**, obligimi vlen nëse tejkalohej një nga pragjet e mëposhtme në vitin e fundit financiar: a) punësimi i më shumë se 50 punonjësve me orar të plotë, b) realizim i qarkullimit mbi 9,000,000 euro, ose; c) vlera e asetëve neto tejkalon shumën e 4,500,000 euro.

Në **Kroaci**, OShC-të me të ardhura totale ndërmjet 3 – 10 milionë HRK (rreth 400,000 – 1,330,000 euro) i nënshtrohen auditimit të thjeshtuar dhe OShC-të me të ardhura totale mbi 10 milionë HRK duhet t'i nënshtrohen auditimit më rigoroz. Të gjitha OShC-të të cilat obligohen t'i nënshtrohen auditimit duhet të paraqesin raportet e auditimit dhe t'i publikojnë ato në internet.

Në **Holandë**, obligimi i auditimit varet nga pragu financiar. OShC-të nuk duhet të auditohen raportet e tyre, përveç rasteve kur qarkullimi i tyre neto gjatë dy viteve financiare të njëpasnjëshme, dhe pas kësaj pa asnjë ndërprerje, gjatë dy viteve të

²⁷ Ligji Praktik i Thompson Reuters: Organizatat bamirëse në Holandë: përmbledhje. Në dispozicion tek: [Organizatrat bamirëse në Holandë: përmbledhje | Ligji Praktik \(thomsonreuters.com\)](https://www.thomsonreuters.com)

mëvonshme financiare arrin në 40,000,000 Euro ose më shumë. Në **Rumani**, kufiri për auditime përcaktohet në bazë të numrit të anëtarëve/personave të angazhuar. Duhet të caktohet një auditor/censor në shoqata me mbi 15 anëtarë dhe në fondacione me mbi 15 persona të angazhuar.

Në vendet e mbetura, **Finlandë**, **Itali** dhe **Belgjikë**, kërkesa e auditimit përcaktohet në bazë të një kombinimi të pragjeve financiare dhe numrit të punonjësve. Pragjet më të ulëta, si për burimet financiare ashtu edhe njerëzore, janë vendosur në **Finlandë**. Megjithatë, në **Finlandë**, obligimi i auditimit vlen vetëm nëse **të paktën dy pragje tejkalohe në mënyrë kumulative** (p.sh. numri i punonjësve është më i madh se 3 dhe totali i bilancit të gjendjes tejkalon 100,000 euro).

Në **Finlandë** dhe **Itali**, pragjet duhet të tejkalohe për më shumë se një vit financiar, prandaj qarkullimi papritmas i lartë i një viti nuk do të thotë automatikisht se OShC-ja do të duhet të kryejë auditime të detyrueshme. Gjithashtu, në të dy këto shtete, duhet të tejkalohe të paktën 2 nga 3 pragje të përcaktuara nga ligjet në mënyrë që të vlejë obligimi i auditimit. Në **Belgjikë**, OShC-të obligohen të kryejnë auditim menjëherë pasi që tejkalohe njëri prag, megjithatë, pragjet e vendosura janë dukshëm më të larta se ato në **Finlandë** ose **Itali**.

4.3 Raportimi tatimor

OShC-të u nënshtrohen obligimeve të ndryshme të raportimit tatimor në bazë të llojeve të aktiviteteve në të cilat angazhohen, burimin e të hyrave të tyre dhe kriterëve të tjera lidhur me pronën dhe të hyrat. Në **Itali**, **Finlandë** dhe **Holandë**, OShC-të mund të **lirohen nga obligimi për të paraqitur deklaratë tatimore mbi të hyrat** nëse plotësohen disa kushte. Në **Itali**, OShC-të që nuk janë të regjistruara në TVSH dhe nuk kanë të hyra të tatueshme në përgjithësi lirohen nga obligimi i paraqitjes së deklaratave vjetore tatimore mbi të hyrat. Të hyrat nga aktivitetet ekonomike, të hyrat nga prona apo të hyrat nga kapitali, në **Itali** zakonisht konsiderohen të hyra të tatueshme. Në **Finlandë**²⁸ dhe **Holandë**, ligjet parashikojnë një listë kushtesh në të cilat OShC-të obligohen të paraqesin deklaratë tatimore. Nëse asnjë nga këto kushte nuk plotësohet, OShC-të lirohen nga paraqitja e deklaratës së tatimit mbi të hyrat.

Në **Belgjikë**²⁹ dhe **Rumani**³⁰, të gjitha OShC-të duhet të paraqesin deklaratat e tatimit mbi të hyrat e korporatave, pavarësisht se a kanë ato të hyra të tatueshme në vitin e caktuar.

²⁸Deklarata tatimore për OShC-të në Finlandë: <https://www.vero.fi/en/businesses-and-corporations/taxes-and-charges/associations-and-foundations/tax-return/>

²⁹https://finances.belgium.be/fr/asbl/impots_et_tva/declaration-asbl-impot-des-personnes-morales#q9

³⁰https://static.anaf.ro/static/10/Anaf/formulare/101_OPANAF_4072_2020.pdf

OShC-të mund të jenë subjekt i obligimeve të tjera të raportimit tatimor varësisht prej të hyrave të tyre dhe llojeve të aktiviteteve. Për shembull, nëse kryejnë aktivitete ekonomike fitimprurëse të rregullta, të cilat nuk janë të liruara nga TVSH-ja dhe/ose gjenerojnë të hyra që tejkalojnë kufijtë e caktuar financiarë, OShC-të në të gjitha shtetet e hulumtuara duhet të regjistrohen në tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe të dorëzojnë deklarata tatimore periodike. Gjithashtu, OShC-të janë të detyruara të paraqesin deklarata tatimore të TVSH-së nëse regjistrohen vullnetarisht në TVSH.

Në **Finlandë**, OShC-të duhet të paraqesin deklaratat e tatimit mbi të ardhurat nëse kanë pranuar të ardhura të tatueshme në vitin e caktuar financiar. Përveç kësaj, OShC-të obligohen të paraqesin deklarata tatimore nëse: i) të dhënat e pronës që është në pronësi të OShC-së kanë ndryshuar apo nëse OShC-ja ka shitur ose blerë pronën gjatë vitit financiar; ii) ka pasur ndryshim material në aktivitetet ose mbledhjen e fondeve të OShC-së; iii) Administrata Tatimore kërkon nga OShC-ja të paraqesë deklaratë tatimore.

OShC-të në **Finlandë** të cilat obligohen të paraqesin deklaratat e tatimit mbi të ardhurat përfitojnë duke pasur deklarata tatimore të thjeshtuar krahasuar me bizneset. Deklaratat tatimore janë krijuar posaçërisht për OShC-të dhe subjektet e tjera të ngjashme dhe kërkojnë paraqitjen e informacionit të mëposhtëm: Specifikimi i OShC-së (duke përfshirë numrin e anëtarëve etj.), shumat financiare të pranuar në bazë të llojeve të të ardhurave (tarifat e anëtarësimit, shitjet e mallrave dhe shërbimeve etj.), specifikimi i shitjeve që janë të liruara nga tatimi në mallra dhe shërbime, sqarime të tjera (si anëtarësimi në ndonjë grup subjektësh), rezultatet e tatueshme të humbjes së lejueshme, si dhe informacioni kontaktues.

Në **Hollandë**, OShC-të duhet të paraqesin deklaratat e tatimit mbi të ardhurat: i) nëse kryejnë aktivitet ekonomik, ose të paktën aktivitet me pagesë i cili i nënshtrohet TVSH-së e cila tejkalon 15,000 euro; ii) nëse kanë punonjës; ose iii) nëse marrin dhuratë/trashëgimi dhe nuk kualifikohen si organizata me përfitim publik me statusin holandez "ANBI".

4.4 Kërkesat e legjislacionit kundër pastrimit të parave (PPP)

OShC-të në shtetet e përzgjedhura nuk janë subjekt i kërkesave të raportimit financiar sipas legjislacionit kundër pastrimit të parave/kundër financimit të terrorizmit (PPP/LFT). Ato gjithashtu nuk konsiderohen të jenë subjekte që obligohen sipas legjislacionit në fuqi të PPP/LFT. Bullgaria është shtet anëtar i BE-së ku ka kërkesa për shoqata dhe fondacione sipas rregulloreve kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Megjithatë, as në Bullgari, shoqatat nuk trajtohen në mënyrë të barabartë me subjektet e tjera që i nënshtrohen obligimit, dhe ato duhet të miratojnë rregulla të brendshme kundër pastrimit të parave nëse qarkullimi i tyre kalon 10,000 euro.

4.5 Llojet e tjera të raportimit financiar

Krahas me kërkesat e raportimit që u përshkruan më sipër, OShC-të mund të nënshtrohen ndaj **kërkesave të tjera raportuese** që rrjedhin nga ligjet në fuqi. Në **Itali** dhe **Finlandë**, OShC-të janë subjekt i kërkesave shtesë për raportim kur ato realizojnë **aktivitete për ngritje të fondeve**. Në **Itali**, pavarësisht nga pasqyra vjetore ekonomike dhe financiare, çdo shoqatë dhe fondacion i cili organizon aktivitet për ngritje të fondeve duhet të hartojë deklaratë të veçantë dhe specifike për të gjitha të hyrat dhe kostot, brenda katër muajve nga përfundimi i vitit financiar. Në **Finlandë**, shoqatat dhe fondacionet duhet të marrin leje për mbledhje të parave/fondeve. Mbajtësit e lejeve më pas detyrohen të raportojnë se fondet e mbledhura janë përdorur për qëllimin që specifikohet në lejen për mbledhje të parave/ngritje të fondeve. Nëse mbajtësi i lejes ka auditor, llogarisë duhet t'i bashkëngjitet një raport auditimi.³¹ Kërkesa të ngjashme të veçanta raportimi mund t'u kërkojnë edhe OShC-ve të cilat pranojnë fonde shtetërore.

5. Konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me politikat

Në bazë të shembujve krahasues të përshkruar më sipër, mund të nxjerrim përfundimet në vijim:

- **Të gjitha shtetet** e përfshira në analizën krahasuese kanë prezantuar **forma të ndryshme të kërkesave të raportimit financiar** për OShC-të.
- Forma më bazike e raportimit financiar që zbatohet për të gjitha OShC-të në të gjitha shtetet lind nga **obligimi i kontabilitetit/libër-mbajtjes**. Fushëveprimi i kërkesave të kontabilitetit dhe libër-mbajtjes dallon dhe, në të gjitha shtetet, **ajo ka përmasa varësisht prej madhësisë së OShC-së apo llojit të të hyrave**.
- Në 3 shtete, për qëllime të kontabilitetit/libër-mbajtjes, madhësia e OShC-së përcaktohet nga qarkullimi vjetor dhe/ose numri i punonjësve. Në shtetet e mbetura, kontabiliteti/libër-mbajtja dallon për OShC-të me dhe pa aktivitete ekonomike. **OShC-të e vogla dhe OShC-të pa aktivitete ekonomike obligohen të mbajnë vetëm llogari të thjeshtuara**.
- Llogaritë e thjeshtuara zakonisht përbëhen nga pasqyra të rrjedhave monetare ose pasqyra të tjera financiare të thjeshtuara që tregojnë transaksionet e OShC-së brenda vitit financiar.
- Në shtetet e hulumtuara **vetëm OShC-të e mëdha u nënshtrohen kërkesave të auditimit**. Madhësia e OShC-së përcaktohet në bazë të kushteve të ngjashme me ato për obligimet e kontabilitetit, mirëpo, pragjet janë, në shumicën e rasteve, dukshëm më të larta. Kjo ndodh për të shmangur

³¹ Finlanda: Ligji për mbledhjen e parave, Neni. 21. Në dispozicion tek: <https://www.finlex.fi/en/laki/kaannokset/2006/en20060255.pdf>

imponimin e kërkesave të rënduara të raportimit për OShC-të e vogla me qarkullim të ulët dhe/ose me shumë pak punonjës apo pa asnjë punonjës.

- OShC-të u nënshtrohen **obligimeve të ndryshme të raportimit tatimor** në bazë të llojeve të aktiviteteve në të cilat angazhohen, burimin e të hyrave të tyre dhe kritereve të tjera lidhur me pronën dhe të hyrat. Në 3 nga 5 shtete, OShC-të duhet të paraqesin deklarata tatimore vetëm nëse kanë të hyra të tatueshme në vitin e caktuar financiar. Në 2 shtetet e mbetura, të gjitha OShC-të duhet të paraqesin deklarata tatimore.
- Në shumicën e shteteve, nëse një OShC nuk lirohet nga obligimi për të paraqitur deklarata tatimore, ajo duhet të përdorë të njëjtin formular raportimi si kompanitë fitimprurëse. Si praktikë e mirë, në Finlandë, **OShC-të kanë formularin e tyre specifik të deklarimit tatimor i cili është i përshtatur për llojet e aktiviteteve dhe të hyrave që zakonisht kanë OShC-të.**
- OShC-të mund të jenë subjekt i **obligimeve tjera të raportimit tatimor**, duke përfshirë deklarimin e TVSH-së, **varësisht prej llojit të të hyrave që ato kanë.**
- Për dallim nga Kosova, OShC-të në të gjitha shtetet e përfshira **nuk kanë asnjë detyrim specifik për raportim financiar të PPP-së dhe nuk janë subjekte të obliguara sipas legjislacionit për PPP.**
- OShC-të mund të obligohen me detyrime të tjera të raportimit financiar, për shembull, në **bazë të llojit të fondeve që ato ngrisin/mbledhin.** Në disa prej shteteve, janë vendosur obligime të raportimit shtesë për OShC-të të cilat realizojnë mbledhje të parave/ngritje të fondeve apo të cilat pranojnë fonde publike.

Në bazë të konkluzioneve të analizës, **rekomandohet zbatimi i praktikave të mëposhtme për të përmirësuar kërkesat e raportimit financiar në Kosovë:**

- **Ndryshimi i ligjit për PPP për të liruar OShC-të nga fushëveprimi i subjekteve të obliguara dhe heqja e kërkesave të raportimit financiar të përfshira në të.** Asnjë nga shtetet e përfshira në këtë dokument nuk ofron ndonjë raportim financiar të ngjashëm dhe detyrime tjera lidhur me PPP-në për OShC-të e tyre.
- Për të trajtuar nevojën për transparencë në të hyra dhe shpenzime të OShC-ve, të fillohet një diskutim më i gjerë për **ndryshimin e ligjit të Kontabilitetit për të krijuar kornizën bazë të raportimit financiar për të gjitha OShC-të.** Ligji aktualisht përfshin një sistem të përmasave të organizatave të biznesit i cili mund të përshtatet me kontekstin e OShC-ve dhe të sigurojë detyrime të ndryshme të kontabilitetit për OShC-të në bazë të madhësisë së tyre apo llojit të aktiviteteve për të ndjekur parimin e barazisë.
- Auditimet duhet të jenë në përputhje me parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit dhe të jenë obligative vetëm për OShC-të e mëdha në mënyrë që të mos krijohen kushte tepër të rënduara për OShC-të e vogla.
- Në bazë të praktikave krahasuese, **është praktikë e mirë që të kërkohet aplikimi i deklaratave tatimore vetëm nga OShC-të me të hyra të tatueshme.** Rekomandohet si praktikë e mirë të krijohet një **format i dedikuar i raportimit tatimor për OShC-të** i cili i përshtatet llojit të të hyrave dhe shpenzimeve që OShC-të zakonisht kanë.

- Nëse ka nevojë për transparencë të mëtejshme të financave të OShC-ve, rekomandohet që gjithmonë të përcaktohen detyrime të reja financiare në bazë të parimit të **ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit** dhe ato duhet gjithmonë të ndjekin **qëllime legjitime**.